Kronikë

Vritet 68-vjeçari në Mirditë, qëllohet me breshëri plumbash nga dritarja e dhomës ku flinte! E bija e gjen të vdekur pas 2 ditësh (FOTO)

Një 68-vjeçar është vrarë me armë zjarri në banesë në fshatin Lajthizë në Mirditë. Frederik Radi, sipas policisë, është qëlluar me armë nga dritarja e dhomës ku flinte. ***Shoqërohen disa banorë të zonës****. E bija lajmëroi sot policinë se ka gjetur të atin të vdekur, prej 2 ditësh kishte humbur kontaktet me të.*

Frederik Radi, u gjet i vrarë në banesë në Lajthizë të Mirditës, 20 gusht 2024

Redaksia
20 Gusht, 08:35 | **Përditesimi: 20 Gusht, 10:34**

Share

MIRDITË- Një 68-vjeçar është gjetur i vrarë me armë zjarri në banesën e tij në fshatin Lajthizë në Mirditë. 68-vjeçari, Frederik Radi, kalonte muajt e verës në këtë banesë, por ka gjetur vdekjen në rrethana ende të paqarta. Sipas policisë, ai është qëlluar me armë zjarri nga dritarja e dhomës ku flinte.

68-vjeçari është gjetur dy ditë pas vrasjes nga e bija Leonora Radi. Pasi ka humbur kontaktet me babanë, e bija ka shkuar në banesë, por të atin e ka gjetur të shtrirë në banesë pa shenja jeta. Më datë 20 gusht ajo ka bërë denoncimin në polici se ka gjetur babanë të pajetë, ndërsa kontaktet me të i kishte humbur prej datës 18 gusht, ditë kur dyshohet se ka ndodhur edhe vrasja.

Burime bëjnë me dije se 68-vjeçari është qëlluar me breshëri plumbash brenda banesës se tij. Ende nuk ka një piste konkrete hetimi, pasi Radi nuk njihej si person problematik dhe me precedent penal.

[Sh.com]

LEXO EDHE:
Vrasjet në vend, Salianji: Krimi ka marrë dhenë, ministri Brendshëm s'dihet ku është fshehur! Sula: Rendi si 'ligji i xhunglës'

> *"Më datë 20.08.2024, shtetasja Leonora Radi ka njoftuar Policinë se ka gjetur të pajetë babanë e saj, shtetasin Frederik Radi, 68 vjeç, në banesën e familjes në fshatin Lajthizë, njësia administrative Orosh, ku 68-vjeçari kalonte muajt e verës. Prej 2 ditësh ai kishte humbur kontaktet me familjarët.*
>
> *Menjëherë drejt vendit të ngjarjes janë nisur shërbimet e Policisë vendore dhe grupi i posaçëm hetimor. Nga këqyrja paraprake e vendit të ngjarjes dyshohet se 68-vjeçari është qëlluar me armë zjarri, nga dritarja e dhomës ku flinte, dhe si pasojë ka humbur jetën", njofton policia.*

Për zbardhjen e ngjarjes, policia ka shoqëruar disa banorë të zonës të cilët janë marrë në pyetje. Motivi i vrasjes dhe rrethanat janë ende të paqarta, ndërsa Prokuroria po kryhen hetime intensive për të identifikuar dhe kapur autorin/ët.

SI.E./Shqiptarja.com

TAG: Lezhë vrasje mirditë Frederik Radi

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

SH.COM

Sondazhi i ditës:
Kredimarrësit e këqinj s'do marrin më kredi, si e vlerësoni rregulloren e BSH?

Të mirë Të keqe Nuk e di

Lajme të tjera

Marrëveshja me Italinë, më 1 shtator hapen kampet për emigrantët, sot testi i fundit! 500 karabinierë zbresin në Shëngjin e Gjadër
20 Gusht, 09:03

Aksident tragjik në aksin Lezhë-Shëngjin, makina humb drejtimin nga shpejtësia e lartë! Ndërron jetë i riu
20 Gusht, 08:07

E rëndë në Tiranë/ Mësuesi amerikan mbyt gruan me litar, dy qentë i vret me shkop bejsbolli, më pas var veten! Letra për babanë: Më fal, nuk ia dola dot (FOTO)
19 Gusht, 21:58

Lezhë/ Makina godet autobuzin e linjës Shkodër- Tiranë! Mjeti më pas përplaset nga një kamion
19 Gusht, 17:47

Lezhë, 24 vjeçari përplas me makinë 72 vjeçaren, e moshuara vdes
19 Gusht, 13:39

Kurbin/ Dy familje sherr me armë e sende të forta për tokën! Babë e bir plagosin 3 vëllezër, njëriu e qëllojnë me armë, 2 të tjerë i dhunojnë fizikisht
19 Gusht, 13:07

Marrëveshja me Italinë, më 1 shtator hapen kampet për emigrantët, nesër testi i fundit! 500 karabinierë zbresin në Shëngjin e Gjadër
19 Gusht, 10:07

E rëndë në Spanjë, 11-vjeçari vritet gjatë lojës së futbollit në fushën e qytetit! Autori e qëlloi aq herë sa kishte dhe moshën
19 Gusht, 09:04

VIDEO/ Krim horror në SHBA, vjehrra ish-police vret nusen e djalit dhe mbesën 4-vjeçare, më pas vetëvritet! Zbulohet shkaku, donte që kujdestarinë ta merrte i biri
19 Gusht, 08:39

Kurbin/ Me motor pa targa dhe i armatosur po shkonte të vriste kushëririn e tij, arrestohet 53-vjeçari (EMRI+VIDEO)
18 Gusht, 10:40

Pasuroi kulturën shqipe! Del në dritë vepra letrare e klerikut Don Jak Zekaj

Elvis Hila
17 Gusht, 16:41

Lezhë/ Kapet në mes të pyllit duke kultivuar kanabis, asgjësohen 250 bimë! Arrestohet 43-vjeçari
17 Gusht, 10:54

HOROSKOPI

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2024 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje